



## PROCESVERBAL III/2024

I mbajtur me rastin e mbledhjes së III (tretë) për vitin 2024 të Komitetit për Politikë dhe Financa të KK Suharekë

---

**Vendi:** KK Suharekë  
**Zyra:** Salla e Bordit të Drejtorëve  
**Data:** 20.03.2024  
**Ora :** 13:00

---

### **Prezentë:**

**Z. Bexhet Kuçi - Kryesues**  
*z. Urim Suka*  
*znj. Bulëza Kuçi*  
*znj. Sanie Kuçi Rexhepaj*  
*znj. Fidaije Kukaj*  
*z. Dardan Berisha*  
*z. Liridon Fandaj*

### **Të pranishëm tjerë:**

**Kryetari i Komunës z. Bali Muharremaj**  
Habibe Bytyqi - zyrtare për barazi gjinore  
Reshat Reshitaj - Zyrtar për informim  
Përfaqësues i OSBE-së  
Përfaqësues i LMT-së

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit z. Bexhet Kuçi i cili propozoi këtë:

### **Rend dite**

- 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake;**
- 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**
- 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për lirimin nga taksa për legalizim të ndërtimeve pa leje për gratë dhe ndërtimet në bashkëpronësi të burrit dhe gruas;**
- 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban për Komunën e Suharekës për periudhën 2024-2034;**

**Kryesuesi** - e hedhë në votim rendin e ditës.

**Unanimisht Miratohet**

**Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 1.

**Unanimisht Miratohet**

**Pika 2. Shqyrtimi i projekt-vendimit për përmbushjen dhe tejkalimin e planit buxhetor të të hyrave vetanake;**

**Kryesuesi** - elaboron pikën dhe hap debatin.

**Urim Suka** - sa i përket kësaj pike, këtu po shkruan që barten 554.753€ por në fakt ne e dimë që shuma e mjeteve të pa shpenzuara është shumë më e madhe se kaq. 1.500.000 ju veq i keni deklaruar më herët pa këtë tre mujor. A mund dikush të na sqaroj se për çfarë bartje po bëhet fjalë?

**Labinot Halitjaha** - me ligjin e ri dhe rregulloren e re të financave, mjetet të cilat kanë tepër barten automatikisht nga Ministria e Financave ndërsa pjesa tjetër që veq është tejkaluar në bazë të planifikimit duhet ta bartim, pjesa tjetër ka me kalu automatikisht në projekte.

**Kryesuesi** - vitet e kaluara gjithmonë janë bartë ato çka janë pa shpenzu kurse për këtë vit me rregullore të re kanë leju me u nda, me u bartë tepricat dhe ne po flasim vetëm për tepricat.

**Kryetari** - nëse kanë qenë 10.000€ në Bllacë, 5.000 në Gjinoc etj, të hyrat vetanake barten automatikisht.

**Avni Bytyqi** - zyrtari ligjor jep sqarime dhe thotë që ligji për buxhetin çdo vit miratohet dhe këtë vit ligji për buxhetin ka pas ndryshime, atë që e tha Drejtori.

**Urim Suka** - meqenëse kjo është e rregulluar me ligj po e kuptoj që mjetet që kanë mbet nga projektet e caktuara do të barten për projekte të caktuara si kanë qenë më herët ndërsa teprica ndahet në projekte të reja. Drejtor ndërlihem te një përgjigje që ti ma ke dhënë në Asamble kur kemi fol për propozimet e

asamblastëve që pse nuk janë marrë parasysh propozimet në buxhet dhe ju keni thënë që me bartjen e mjeteve të gjitha propozimet kanë me figuruar në bartjen e mjeteve. Kur unë tash po e lexoj dokumentin, asnjëri prej propozimeve të miratuara në kuvend nuk figuron në këtë projekt-vendim që e ke sjell. A mund të na japësh sqarime pse ka ndodh kjo?

**Labinot Halitjaha** - e kam tregu që në bazë të projekteve kur të ndahen mjetet ne bëjmë edhe paramasa se si kanë me u rregullu pjesa tjetër, do ti fusim në paramasë pikat e fundit që kanë qenë për buxhetin 2025.

**Urim Suka** - ti e din që ato me paramasë nuk bëhen me ligj. Unë po flas për procedura ligjore.

**Kryetari** - kodi lart nuk ndryshohet por në paramasë hynë. Tash me projekt bëhen dhe sa dalin, dalin. Paret janë aty.

**Urim Suka** - mua më vje mirë që keni fillu me bë projekte. Tash kur ti fillon me bo projekte shihet konkretisht me atë mesatare sa rrugë mun me shtru dhe mundesh me planifikuar shumë mirë buxhetin detaisht me ditë sa pare mundesh me inicu për secilën rrugë dhe nuk i ke këto probleme që i ke tash.

Ajo që ka ndodh në atë asamble atëherë kur janë propozua rrugë që nuk i keni fut në buxhet, ajo është gabim i madh. Nuk duhet me ndodh këto nëpër asamblatë komunale kur ne vendosim diçka tjetër, punohet diçka tjetër, bëhet diçka tjetër. Jemi në vitin e 7-të të mandatit dhe tash ka fillu me punu me projekte.

**Kryetari** - projekte të mëdhaja kemi pas, s'kemi pas projekte nëpër fshatra sepse ti e din që nëpër fshatra ka rrugë edhe 50m, 70m dhe 100m. E dini që kanë ndryshu çmimet. Ne e dimë që një metër kubëz është 8 € dhe ai hyn për 6€ dhe nuk i kryen punët. Kryetari tutje jep sqarime.

**Liridon Fandaj** - te këto projekte që janë këto mjete, këto e kanë një planifikim. P.sh. Rruga "Skënderbeu" e ka pas një planifikim për dy vjet. I kemi bart në vitin 2022 prej kodit të bujqësisë dhe në fund të vitit Kryetari merr vendime dhe pa përfill asamblenë i ka shpërnda këto mjete. Tash po na vje e njëjta rrugë me u aloku prapë mjete. Çka ndodh nëse në fund të vitit prap nuk shpenzohen dhe barten ato pa vendim të asamblesë sepse ajo e tejkalon 5% të buxhetit. Te ajo që thatë buxhetin e shpërndan ministra, ministra duhet me pas një listë ku me i shpërnda se ka projekte që janë të përfunduara. Nëse mund të sqaroni se ku kanë me u aloku ato mjete.

**Kryetari** - Kryetari i Komunës ka të drejtë vetëm 5% në komplet buxhetin. Të hyrat vetanake vitin e kaluar kanë qenë afërsisht 500.000€. Barten të njëjtat projekte sipas ligjit në fuqi dhe nëse në Peqan kanë mbet 5000, kanë me shku në Peqan.

**Liridon Fandaj** - shpërndarjen duhet me dediku dikun dhe jo me bart ashtu automatikisht.

**Kryesuesi** - e hedhë në votim pikën 2.

**4 për, 3 kundër**  
**Miratohet pika 2**

### **Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për dhënien e pëlqimit për të zhvilluar procedurat përmes konkurrimit të hapur për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Urim Suka** - a bëhet fjalë për daljen nga Suhareka rrugës për Prishtinë dhe a është një vijë për gjatë rrugës? Pse duhet kjo pjesë me u shfrytëzu për ndërtim nuk po e kuptoj sepse është shumë vijë e hollë për gjatë rrugës dhe ndoshta në një të ardhme mund të parashihet që të zgjerohet rruga. Çfarë interesi ka komuna për me dhënë në ndërtim? Kërkoj sqarime.

**Visar Kuçi** - në të kaluarën Pojata ka pas plan rregullues dhe plani rregullues ku ka pas prona publike ka parapa ose gjelbërim ose ndonjë shirit në shfrytëzim të pronave shoqërore. Harta zonale në këtë rast e ka të caktuar sa ka me qenë e gjerë rruga "Brigada 123" dhe pjesa tjetër nuk e ka shiku a është e komunës apo e privatit por e ka caktu gjerësinë e rrugës. Në këtë rast gjersia e rrugës është vendos në harta zonale dhe kjo parcelë me sipërfaqe 2900 m<sup>2</sup> ka mbet në disa destinime ku njëra prej sipërfaqes është rrugë, një pjesë e ka mbet në ZSHP4 dhe një pjesë ka mbet në ZSHP5. Ne si komunë e kemi obligim që çdo kund ku lejohet ndërtimi, ne jemi të obliguar me hy në ndërtim se sa të mbes parking ose me shfrytëzu dikush prej privatit. Këtu përfiton komuna. Drejtori tutje jep sqarime.

**Urim Suka** - në rastin konkret konkurrimi i hapur si shkon si procedurë?

**Visar Kuçi** - ne si komunë e qesim në ankand publik.Komisioni që formohet ka me i vendos kusht secilit që e merr me u bashku me bllokun e ndërtimit.

**Urim Suka** - a e dini cili është interesi i komunës?A keni një marrëveshje me palën çka mund të përfitoj komuna në këtë drejtim apo s'ka marrëveshje.

**Visar Kuçi** - me u pyt unë si drejtor i Urbanizmit,i marrim për bazë kontratat që i ka me privatën por komuna nuk ka një ligj që duhet me pas dhe unë jam i sigurt që kur të nisen procedurat ne kemi me pas një prag që nën atë përqindje nuk e japim që mos ta dëmtojmë pronën komunale.

**Liridon Fandaj** - ti po i zhvillon procedurat për dhënie në shfrytëzim për 99 vjet dhe nuk mund të vendosësh përqindje sepse nuk je duke bërë këmbim.

**Visar Kuçi** - jo sepse ti po e jep në shfrytëzim bllok ndërtimi në ZSHP4.

**Liridon Fandaj** - ajo ka me u dhënë me kosto financiare,ka me dal një çmim.Tash ai këmbimin mundet me ta dhënë kosto financiare të metrave katror aty.

**Visar Kuçi** - ne e japim në shfrytëzim për 99 vite dhe vendosen kushtet për parcelën se për sa vite jepet në shfrytëzim,se si do të shfrytëzohet etj.

**Avni Bytyqi** - konkurrimi i hapur është për të gjithë dhe çdo kush ka të drejtë të konkurroj dhe ta merr.Nëse e merr ai që nuk e ka bë kërkesën,ai pastaj bën marrëveshje me atë që e ka bë kërkesën.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - nëse ajo ish dediku për investitorin,ne s'do t'kishim hap konkurrimin. Konkurrimi është për të gjithë.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 3.

**3 për,3 kundër,1 abstenim**

**Kryesuesi e përdor votën e dyfishtë dhe voton për.**

**Miratohet pika 3**

**Pika 4. Shqyrtimi i projekt-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës;**

**Kryesuesi** - e elaboron këtë pikë dhe hap debatin.

**Urim Suka** - mos është ndonjë gabim teknik sepse vendimi është tjetër.Kërkoj sqarime.

**Avni Bytyqi** - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që është një gabim teknik dhe vendimi brenda dokumentit është në rregull.

**Liridon Fandaj** - ky komision është me pagesë.Ky 50 € në bazë të kujt përcaktohet? Sepse nëse ka ndryshu ligji atëherë duhet të rritet edhe kjo vlerë e komisionit.

**Avni Bytyqi** - si zyrtar ligjor jep sqarime dhe thotë që çështja e kompensimeve të komisioneve as një akt ligjor nuk e rregullon. Këtë e kemi bë prej vullnetit të mirë,prej vitit 2012 që kemi fillu me dhënë prona publike përmes komisionit të asamblesë për shkak se anëtarët e kuvendit kanë pas një kompensim që ka qenë më pak se minimale. Prej vitit 2023 e tutje anëtarët e kuvendit kanë pagë dinjitoze dhe nuk ka nevojë me qenë fare 50 eurosh.

**Armend Krasniqi** - duhet me propozua dhe duhet me bë nga 179 € për çdo komision sepse komunat tjera e praktikojnë.

**Avni Bytyqi** - asnjë komunë tjetër nuk e praktikon me pagesë. Komuna Suharekës e ka bë e para. Për mua sa të doni mund ta bëni.

**Liridon Fandaj** - Kryesuesi e udhëheq Kuvendin dhe Kryesuesi mund të sjell vendim dhe ne me vendos. Edhe te kryetarët e këshillave, ligji s'ka ndryshu.

**Avni Bytyqi** - ka ndryshuar me ligjin e pagave. Te dispozitat kalimtare dhe përfundimtare,konkretisht te shfuqizimi i akteve ligjore janë 12-13 ligje që i specifikon qartë. Pragrafi dy thotë:shfuqizohen të gjitha aktet nënligjore që bien ndesh me ligjin e pagave e që kanë të bëjnë me çështjen e financimit dhe kompensimeve. Udhëzimet administrative që i ka nxjerr ministria nuk janë obligative. Zyrtari ligjor tutje jep sqarime.

**Urim Suka** - ky vendim që po e marrim,a është vendim deri në fund të mandatit ?

**Avni Bytyqi** - komisioni për vlerësimin e ofertave duhet të formohet për çdo pronë që jepet në shfrytëzim ndërsa komisioni për ankesa ka mandat dy vjeçar, aq sa ka kuvendi tash.

**Urim Suka** - unë dua ta lidh këtë 50€ me atë të komisionit të stacionit të autobusëve. Është gabim që ne i njejtë institucion një vendim me marrë dhe dikujt me ia dhënë 50€ dhe dikujt 200€.

**Avni Bytyqi** - mos thoni ka bazë ligjore sepse nuk ka. Vendimi është i Kuvendit dhe sa të doni mund ta bëni.

**Urim Suka** - unë kisha thënë me marrë një vendim që për krejt e rregullon.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 4.

**Unanimisht Miratohet**

#### **Pika 5. Shqyrtimi i projekt-vendimit për lirim nga taksa për legalizim të ndërtimeve pa leje për gratë dhe ndërtimet në bashkëpronësi të burrit dhe gruas;**

**Kryesuesi** - e elaboron pikën dhe ia jep fjalën Sanie Kuçi Rexhepaj.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - ky është një propozim prej grupit të grave të kuvendit me qëllim të fuqizimit të gruas në pronë. Ligji për legalizim ka fillu me u zbatu në vitin 2019 në komunën e Suharekës dhe në bazë të statistikave vetëm një shtëpi është e legalizuar në pronë të përbashkët të burrit dhe gruas dhe 16 objekte janë në emër vetëm të grave. Duke i pa këto statistika dhe me qëllim që ta fuqizojmë gruan në pronë atëherë si propozim ka dal që me i liru nga taksa për legalizim të objektit në pronësi të burrit dhe gruas dhe në pronësi vetëm të grave.

**Visar Kuçi** - edhe pse taksa nuk është e lartë dhe për objektet që janë ndërtu deri në vitin 2004 lirohen nga taksa, kjo është një stimulim.

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - ligji për legalizim disa kategori vet i liron nga taksa.

**Avni Bytyqi** - sa i përket çështjes së personave të hendikepuar mendoj që nuk ka nevoj me nxjerr një vendim të veçantë për arsye se ata janë kategori që trajtohen me ligjin e kuvendit të RKS-së.

**Urim Suka** - a paraqet problem me ligjin ky vendim?

**Avni Bytyqi** - jo, e jep këtë kompetencë.

**Urim Suka** - a keni llogarit kosto financiare ?

**Sanie Kuçi Rexhepaj** - si shembull është 1€ m<sup>2</sup> për shtëpi dhe zakonisht 200 m<sup>2</sup> për shtëpi dhe 200€ është kosto për me legalizu objektin në komunë.

**Kryesuesi** - e hedh në votim pikën 5.

**Unanimisht Miratohet**

#### **Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për miratimin e Planit të Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban për Komunën e Suharekës për periudhën 2024-2034;**

**Kryesuesi** - hap debatin për këtë pikë. Pasi nuk ka debat e hedh në votim pikën 6.

**Unanimisht Miratohet**

**Takimi përfundoi: 14:05**

**Procesmbajtësja:  
Dafina Haziraj**